

#PAKTI PËR UNIVERSITETIN

223 TË PUNËSUAR NGA PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS

Në një ceremoni të zhvilluar në kuadër të "Programit Kombëtar të Praktikave të Punës", është bërë prezantimi i 223 të punësuarve falë këtij programi, i cili është në vitin e tij të katërt dhe të konsoliduar.

Në fjalën e saj, Ministria Shahini nënvizoi rëndësinë e veçantë që MASR i kushton lehtësimet dhe mbështetjes në mënyrë të vazhdueshme për kalimin nga arsimit në tregun e punës.

#PAKTI PËR UNIVERSITETIN

VAZHDON SUBVENCIONIMI PËR PËRGJYSMIMIN E TARIFAVE DHE BURSAVE

MASR informon studentët se qeveria shqiptare do të vazhdojë të subvencionojë tarifën dhe bursat edhe për vitin e ardhshëm akademik 2019-2020. Tarifën mbesin, por subvencionimi nga ana e qeverisë shqiptare nuk do të ndalet në mënyrë që t'u vihet në ndihmë studentëve shqiptarë, ashtu sikurse është zotuar në kuadër të "Paktit për Universitetin". Në fillim të këtij viti, "Pakti për Universitetin" solli mbi 2.3 miliard lekë subvencionim pako financiare nga qeveria shqiptare duke i sjellë përfitim direkt mbi 99 mijë studentëve. Shumë shpejt do të ketë edhe ndryshime të tjera në VKM për të përfshirë edhe kategori të tjera që nuk kanë qenë më përpara.

#PAKTI PËR UNIVERSITETIN

MBI 20 MIJË STUDENTË TË PAJISUR DERI MË SOT MË KARTË STUDENTI

Në total janë mbi 20 mijë studentë tashmë të pajisur me Kartën e studentit.

Pas modelit të sukseshëm të ndjekur nga Bashkia e Tiranës, do të vijohet edhe me bashkitë e tjera ku ka universitete.

Bashkëpunimi dhe angazhimi i të gjithëve aktorëve është garancia e suksesit për të pajisur çdo student me kartë.

#PAKTI PËR UNIVERSITETIN

BIBLIOTEKA DIGJITALE

Biblioteka digjitale universitare ulibrary.rash.al është një tjetër kërkesë e plotësuar e studentëve, falas.

Mijëra libra e revista, miliona shkrime e teza online u vijnë në ndihmë të studentëve e pedagogëve për të pasuruar literaturën dhe për ta bërë studimin dhe hulumtimin e tyre më cilësor.

Aktualisht, MASR është duke negociuar me kompaninë EBSCO për të krijuar mundësinë në akses tek literatura në gjuhën shqipe.

RINIA

"SHKOLLA VERORE 2019"

120 studentë nga Shqipëria dhe Kosova janë bërë bashkë përgjatë katër ditëve të "Shkollës Verore 2019" (Jalë, 24-27 Korrik, 2019).

Të rinjtë janë angazhuar në një sërë aktiviteteve edukative, sportive dhe kulturore duke i dhënë gjallëri bregdetit të Jalës.

Në lidhje me këtë eksperiencë, studentët janë shprehur se do ta mbajnë mend gjatë, pasi sapo kanë nisur një miqësi, që do i afrojë më shumë me njëri - tjetrin në distancë dhe në kohë.